

VENDIM
Nr.22, datë 21.1.2000

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.160, DATË 18.3.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE, TË OBJEKTEVE DHE TRUALLIT TË UZINËS SË PRODHIMIT TË MAKINERIVE, NË TIRANË, DHE TË TRUALLIT NË ISH-KËNETËN E DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1, të ligjit nr.7649, datë 16.12.1992, “Për krijimin e bankës së përbashkët italo-shqiptare”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.160, datë 18.3.1996, të Këshillit të Ministrave, pikat 1,2,3 dhe 4 shfuqizohen.

2. Autorizohet Banka Kombëtare Tregtare, sh.a., që, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të kryejë të gjitha veprimet e duhura për t’ia rikthyer pronarit të mëparshëm Uzinën e Prodhimit të Makinerive, në Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta